



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 313/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të keq përdorimit të votës – fotografimi i votës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.313/2019 e datës 06.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të keq përdorimit të votës – fotografimi i votës.

## A r s y e t i m

Me datë 06.10.2019 subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.313/2019, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën ka pretenduar, se me datë 06.10.2019 rreth orës 13:50, kemi marr një mesazh nga rrjeti social facebook, ku shihet se një person i ka shkruar degës së LDK-së, duke i dërguar një foto të fletëvotimit të plotësuar, ku shkruhet “*e fotografova votën, ku duhet me shku mi marr paret*”, veprim ky i ndaluar me nenin 33 pika f), lidhur me nenin 36 par.1 të LPZ-së. Paraqitësi i ankesës si provë për pretendimet e tij i ka bashkangjitur ankesës një fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), konsideron se ankesa e subjektit politik LVV, është e pabazë, e pa argumentuar dhe se nuk ka asnjë provë direkte që e faktон këtë supozim, sepse faqja LDK Dega Istog, nuk është faqe zyrtare e degëve të LDK-së, siç mund të vërtetohet nga fotografitë e bashkangjitura kësaj përgjigje. Parashtruesi i përgjigjes më tutje thekson se çdokush mundet që t'i shkruaj ndonjë individi apo faqeje të tillë në messenger të facebook-ut, si në rastin konkret, dhe po ashtu nuk dihet se kush është personi që ka shkruar se e ka fotografuar votën, pasi që nuk ka komunikim reciprok, që do të thotë nuk ka shitblerje vote, ngase ka vetëm një palë që shkruan. Andaj konsiderojmë se pretendimi ankimore i Lëvizjes Vetëvendosje duhet të hudhet poshtë nga PZAP-i.

PZAP-i, me qëllim që të hetohet rasti në fjalë i është drejtuar Policisë së Kosovës – Qendra Komanduese DRP Pejë, të cilët në Raportin e Stacionit Policor të Istogut të datës 06.10.2019,

lidhur me publikimin e një fletë votimi në rrjetet sociale dhe kërkesës për pagesë për votë, informatë kjo e publikuar në disa portale në internet, ju informojmë se me hetimin e kësaj informate janë marrë Prokurorja e Shtetit Sadie Muriqi dhe Ardiana Veselisi dhe dy hetues rajonal Enver Krasniqi dhe Agron Kolaj të cilët kanë intervistuar një person në cilësinë e dëshmitarit dhe rezulton dyshimi i bazuar se fleta e votimit në fjalë është marrë nga një link në internet dhe nuk bëhet fjalë për fletë votim original. Sipas Prokurores dhe Hetuesve të lartëcekur nuk ka elemente për këtë rast.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, provës materiale – fotografisë së bashkangjitur dhe Raportit të policisë në Komunën e Istogut, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është e pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim te nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli nuk mundi të konstatoj se kush e ka shkruar atë mesazh në rrjetin social facebook, pasi që në foton e ofruar si provë nuk figuron emri i tij.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet se shkrimi në rrjetin social facebook i referohet subjektit politik LDK, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar se faqja e supozuar në ankesë është faqe zyrtare e Lidhjes Demokratike të Kosovës - Dega Istog, siç pretendohet në ankesë.

Ndërsa nga Raporti i Policisë - Qendra Komanduese DRP Pejë (dërguar në PZAP me email me datë 06.10.2019), rezulton se nuk ka elemente të bazuara për këtë rast sepse fleta e votimit në fjalë është marrë nga një link në internet dhe nuk bëhet fjalë për fletë votim origjinal.

Paneli pas i shqyrtoj dhe e hetoj të gjitha dëshmitë relevante në kuptim të nenit 117 të LZP-së, konstatoi se ankesa e parashtuar nga subjekti politik LVV, nuk mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse për tu miratuar. Kjo përfaktin se nga provat e ofruara në shkresat e lëndës nuk është arritur që të vërtetohet pretendimi i paraqitesit të ankesës.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.313/2019 më datën 07.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.